



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 5636

NR. VENDIMI 8369

**VENDIM**  
**NE EMER TE REPUBLIKES**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, e perbere nga :

**ANTONELA PRENDI – GJYQTARE**

asistuar nga sekretare gjyqesore Dila Doçi, sot me dt 24.10.2016, mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore publike ceshtjen civile me nr 5636 Akti, qe i perket :

**PADITES :** Shoqeria “ \*\*\* “ sh.p.k, me qender ne \*\*\*, me administrator z. \*\*\*, perfaqesuar nga av. \*\*\* dhe av. \*\*\* ne baze te autorizimit dt \*\*\*.

**I PADITUR :** \*\*\*, person fizik qe ushtron aktivitet tregetar me qender ne \*\*\*, rregjistruar ne QKR me dt \*\*\*, me nr NIPT \*\*\* ( **ne mungese**)

**PERSON I TRETE :** Drejtoria e Pergjithshme e Markave dhe Patentave, perfaqesuar nga \*\*\* ne baze te autorizimit nr \*\*\* Prot, dt \*\*\* ( **ne mungese** ).

**OBJEKTI :** Konstatimi i konkurrences se pandershme nepermjet perdorimit te paautorizuar te markes tregetare “ Zgara korcare” nga pala e paditur. Ndalimin e perdorimit te paautorizuar te markes “ Zgara korcare” ne qarkullimin tregetar nga pala e paditur. Shperblimin e demit te shkaktuar nga perdorimi i

paautorizuar i markes “ Zgara korcare” ne vleren \*\*\*  
leke

**BAZA LIGJORE** : Neni 348 i KPrC. Nenet 638, 639 e vijues te KC.Ligji nr 9947, dt 07.07.2008 “ Per pronesine industriale “ neni 156 e vijues.

**Gjykata** pasi administroi provat, deklaroi te mbyllur hetimin gjyqesor, degjoi konkluzionet perfundimtare, ku paditesi kerkoi pranimin e padise dhe si cmoi provat ne teresi

### **V E R E N**

Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte paraqitur per gjykim kerkesepadia me pale ndergjyqese, objekt dhe baze ligjore te sipercituar.

Paraprakisht gjykata konstatoi se kjo mosmarreshje tregtare ben pjese ne juridiksionin gjyqesor referuar nenit 36 te KPrC i cili sanksionon :

*“Ne juridiksionin e gjykatave hyjne te gjitha mosmarreshjet civile dhe mosmarreshjet e tjera te parashikuara ne kete Kod e ne ligje te vecanta “.*

Njekohesisht kjo gjykate gezon kompetencen lendore per gjykimin e ceshtjes ne kushtet kur ndodhemi perpara nje mosmarreshje me karakter tregetar qe rrjedh nga marredhenia juridiko – tregtare e pronesise mbi markat referuar nenit 41 te KPrC :

*“Ne kompetence te gjykates se shkalles se pare jane te gjitha mosmarreshjet civile dhe mosmarreshjet e tjera te parashikuara ne kete Kod dhe ligje te tjera”.*

Ne aspektin tokesor kjo gjykate gezon te drejten e gjykimit te kesaj mosmarreshje tregtare pasi eshte gjykata e vendit ku ushtron aktivitetin tregetar pala e paditur ( neni 43 i KPrC ) dhe gjykata e ngarkuar per shqyrtimin e mosmarreshjeve qe lidhen me te drejtat qe burojne nga pronesia industriale referuar nenit 348 te KPrC :

*“Mosmarreshjet qe rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe te sherbimit, dizenjot industriale, modelet dhe cdo e drejte tjeter qe rrjedh nga pronesia industriale gjykohen nga seksioni i mosmarreshjeve tregtare ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane sipas rregullave te parashikuara nga ky Kod “*

Pas zhvillimit te nje hetimi te gjithanshem gjyqesor, administrimit te provave dhe cmimit ne teresi te tyre rezultoi e provuar :

Paditesi shoqeria “ \*\*\* “ sh.p.k eshte person juridik qe ushtron aktivitet tregetar ne fushen e distribucionit te artikujve ushqimore, importit dhe eksportit te tyre referuar te dhenave te ekstraktit te QKR-se.

Kjo shoqeri ka rregjistruar ne pronesi te saj prane Drejtorise se Pergjithshme te Markave dhe Patentave marken “ Zgara korcare” referuar

certifikates se rregjistrimit te markes nr \*\*\* Prot,dt 28.06.2013 te administruar ne cilesine e proves ne gjykim ( nr rregjistrimit kombetar \*\*\*, dt rregjistrimi 28.06.2013). Kjo marke tregetare referuar teresise se akteve qe i perkasin praktikes se rregjistrimit, te paraqitura ne gjykim nga personi i trete Drejtoria e Pergjithshme e Markave dhe Patentave, perfshihet ne klasen 43, sherbime ( restaurant ) referuar klasifikimit nderkombetar te Nice-s. Marka “ Zgara korcare” shoqerohet me pasqyrimin e saj grafik (fjale e stilizuar) ku mbizoteron mbishkrimi “ Zgara korcare” ne nje sfond ngjyrash e zeze, e bardhe, kafe dhe nuancat e saj.

Ndersa pala e paditur \*\*\* eshte person fizik qe ushtron aktivitet ne fushen e tregetimit te produkteve te zgares sikurse percaktohet ne ekstraktin e leshuar nga QKR me dt 29.02.2016. Ky subjekt tregetar eshte rregjistruar ne QKR me dt 04.03.2014, rezulton aktiv dhe qendra e ushtrimit te aktivitetit eshte ne \*\*\*.

Paditesi \*\*\* sh.p.k i eshte drejtuar kesaj gjykate me padine objekt shqyrtimi me pretendimin se pala e paditur, personi fizik tregetar \*\*\*, perdor ne menyre te paligjshme dhe te paautorizuar marken tregare “ Zgara korcare” , pronesi e pales paditese gjate ushtrimit te aktivitetit te saj tregetar. Emertimi “Zgara korcare “ i ekspozuar nga i padituri ne vendin e ushtrimit te aktivitetit tregetar eshte identike me marken e rregjistruar nga shoqeria “\*\*\* “ sh.p.k prane Drejtorise se Pergjithshme te Markave dhe Patentave referuar elementeve krahasues vizual, fonetik, konceptual etj. Marka “Zgara korcare” gezon mbrojtje ligjore me regjistrimin e saj prane Drejtorise se Pergjithshme te Markave dhe Patentave duke legjitimuar palen paditese, ne cilesine e pronarit te saj te kerkoje mbrojtje ligjore ne rast te cenimit te kesaj marke. Perdorimi i paautorizuar nga pala e paditur i markes “Zgara korcare “ perben cenim te se drejtes se konkurrences. Pala e paditur eshte njoftuar nga paditesi per te drejtat qe gezon mbi marken “Zgara korcare” duke i kerkuar njekohesisht mosperdorimin ne vijimesi te saj.Pales paditese i eshte shkaktuar dem jopasuror si rrjedhoje e cenimit te emrit te mire tregetar dhe imazhit te krijuar ne treg ne kushtet e identifikimit me marken e saj, te sherbimit te ofruar nga pala e paditur, qe nuk gezon cilesite dhe karakteristikat qe individualizojne sherbimin e mbulur nga kjo marke. Ne keto kushte pala e paditur duhet ti demshperbleje paditesit demin jopasuror te pesuar ne vleren \*\*\* leke.

Pala e paditur \*\*\* ne prapesimet e parashtuara gjate gjykimit konfirmoi ekspozimin nga ana e tij ne vendin e ushtrimit te aktivitetit tregetar te markes “ Zgara korcare” per te identifikuar tregetimin e produkteve te zgares, pjese e objektit te veprimtarise tregetare. Kjo pale kerkoji rrezimin e kerkesepadise duke pretenduar se nuk gjendet ne kushtet e perdorimit te

paautorizuar te markes se rregjistruar nga pala paditese. Emertimi “Zgara korcare origjinale “e perdorur prej tij perben nje emer pergjithesues qe simbolizon llojin e produkteve te tregetuara ( zgare) dhe elementin gjeografik te orgjines se tyre.

Gjykata ne perfundim te hetimit gjyqesor, pasi analizoi ne teresi provat ne raport me kerkimet e pales paditese, prapesimet e te paditurit dhe ligjin material qe disiplinon marrdhenien juridike objekt gjykimi konkludon se kerkese padia duhet pranuar pjeserisht.

Nga shqyrtimi i pretendimeve te ndersjellta te paleve te parashtruara gjate hetimit gjyqesor ne respektim te parimit te kontradiktoritetit dhe analizes se tyre ne raport me shkakun ligjor te padise evidentohet ekzistenca e nje konflikti me natyre tregetare i lidhur me perdorimin e markes tregetare “ Zgara korcare “. Ne cilesine e subjektit pronar te markes te rregjistruar prane Drejtorise se Pergjithshme te Markave dhe Patentave paditesi pretendon perdorimin e kundaligjshem dhe te paautorizuar te saj nga pala e paditur, e cila duke perdorur marken ne fjale siguron ekspozimin ne treg ndaj konsumatoreve te sherbimit restorant ne lidhje me produktet e zgares duke cenuar reputacionin dhe emrin e mire ne treg te pronarit te markes dhe duke i shkakuar per pasoje dem jopasuror.

Shqyrtimi i pretendimeve te mesiperme dikton nevojten e analizes se markes se perdorur nga pala e paditur gjate ushtrimit te aktivitetit te saj tregetar, ngjashmerine apo natyren identike me marken “ Zgara korcare “ te rregjistruar nga pala paditese, referuar elementeve ligjore krahasues qe perbejne indicie te mjaftueshme per vleresimin gjyqesor te cenimit te pretenduar te markes tregetare.

Neni 140 i ligjit nr 9947, dt 07.07.2008 i ligjit “ Per pronesine industriale “ sanksionon:

“1.Cdo shenje ose kombinim shenjash qe paraqitet grafikisht dhe qe sherben per te dalluar markat ose sherbimet e nje personi fizik ose juridik, nga ato te nje personi tjeter fizik ose juridik eshte marke qe perfaqeson ato mallra ose sherbime me kusht qe te permbushen kerkesat e neneve 141 deri ne 143 te ketij ligji.

2.Perbejne marke shenjat e meposhtme :

a) fjalet , perfshi emrat personale, shkronjat, numrat, shkurtimet;

b) shenjat figurative, perfshi vizatimet;

c) format dy ose tre dimensionale, format e mallrave dhe/ose ambalazhimi i tyre;

d) cdo kombinim i shenjave te permendura nga shkronja a ) deri ne c ) te kesaj pike...”

Ndersa ne nenin 156 te ligjit nr 9947, dt 07.07.2008 “Per pronesine industriale “ parashikohet :

Te drejtat qe rrjedhin nga rregjistrimi :

1.Pronari i markes se rregjistruar gezon te drejten ekskluzive te perdorimit te markes ne perputhje me te drejttat e parashikuara ne kete ligj.

2.Pronari i markes se rregjistruar gezon te drejten te ndaloje pesonat e trete te perdorim gjate ushtrimit te veprimtarise se tyre tregetare pa autorizimin e tij :

a) nje shenje qe eshte e njejte me marken, per mallra dhe sherbime, qe jane te njejta me ato per te cilat eshte rregjistruar marka;

b) nje shenje qe eshte e njejte ose e ngjashme me marken apo qe per shkak te njellojshmerise apo ngjashmerise se mallrave ose sherbimeve , per te cilat perdoret shenja me mallra ose sherbime qe perdoren nga marka e rregjistruar, mund te shkaktojne konfuzion te publiku, ku perfshihet dhe mundesia e bashkelidhjes se shenjes me marken tregetare;

c) nje shenje te njejte ose te ngjashme per mallra ose sherbime, edhe kur keto nuk jane as te njejta dhe as identifike me ato, per te cilat eshte rregjistruar marka ne rast se marka ka reputacion ne RSH dhe nga perdorimi i shenjes pa shkak te arsyeshem realizohet nje perfitim i padrejte ose demtohet natyra dalluese apo emri i mire i markes.

Neni 184/a E drejta per te vepruar kunder shkeljes se te drejtave.

“E drejta per te ngritur padi ne gjykate per shkelje te te drejtave sipas ketij ligji i perket :

a)pronarit te nje patente, dizenjoje ose marke te rregjistruar...

Neni 184/b Procedura ne rast shkelje.

1.Personat e permendur ne nenin 184/a te ketij ligji kane te drejte ti drejtohen gjykates kunder cdo personi qe shkel te drejttat e tyre per te kerkuar:

a) ndalimin e veprimeve te metejshme qe perbejne shkelje te te drejtave;

b) heqjen ose bllokimin e objekteve qe perbejne shkelje te te drejtave nga qarkullimi civil ose shkaterrimin e ketyre objekteve;

c) heqjen ose bllokimin e mjeteve te perdorura ekskuzivisht ose pothuajse ekzkuzivisht per prodhimin e produkteve qe perbejne shkelje ose shkaterrimin e tyre

c) publikimin e vendimit perfundimtar te gjykates ne media publike me shpenzimet e personit qe ka kryer shkeljen sipas menyres se parashikuar nga gjykata.

2.....Ne shqyrtimin e kerkeses per marrjen e masave te parashikuara ne piken 1 ), shkronjat b) dhe c) gjykata vlereson proporcionalitetin midis rendesise se shkeljes dhe mases se urdheruar si dhe interesat e paleve te treta...”

Neni 184/c. Shperblimi i demeve.

Shkelesi eshte pergjegjes per te gjitha demet qe i jane shkaktuar paditesit. Gjukata ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi vendos per masen e demshperblimit, pervecse kur eshte parashikuar ndryshe. Gjukata ne caktimin e mases se demshperblimit :

a)mban parasysh cdo dem efektiv dhe real, perfshi dhe fitimin e

munguar, qe ka pesuar pala e paditur, cdo perfitim te padrejte te realizuar nga shkelesi si rezultat i konkurrences se pandershme dhe sipas rastit dhe demin moral te shkaktuar mbajtesit te te drejtave nga shkelja, cenimi i emrit dhe reputacioni i tij tregetar.

b) sipas rastit mund te vendose shperblimin e menjehershem te demit duke llogaritur fitimet qe do te siguroheshin ose do te merreshin ne rast se shkelesi do te kishte kerkuar autorizim per perdorimin e te drejtes se pronesise industriale ne fjale”

Neni 638 i Kodit Civil.

Ne varesi te dispozitave qe kane lidhje me mbrojtjen e shenjave dalluese dhe te drejtave te patentes veprimet e konkurrences se pandershme kryhen nga cilido qe 1. Perdor emra dhe shenja dalluese te cilat mund te sjellin ngaterrese me emrat dhe shenjat dalluese te perdorura ligjerisht nga te tjeret ose imiton produktet e nje konkurrenti ose kryhen veprime te cilat sjellin ngaterresa me produktet ose veprimtarine e nje konkurrenti 2. trajton si te vetat cilesite e produkteve ose te ndermarrjes se konkurrentit 3. perdor vete drejteperdrejte ose terthorazi cdo mjet tjeter qe nuk perputhet me parimet e ndershmerise profesionale dhe mund te demtoje veprimtarine e tjetrit.

Neni 639 i Kodit Civil.

“Vendimi qe verteton veprime te konkurrences se pandershme ndalon vazhdimin e tyre dhe percakton masat e nevojshme me qellim qe te zhduken pasojat. Ne qofte se keto veprime jane kryer me faj personi qe i ka kryer detyrohet te shperbleje demin “

Rregjistrimi i markes tregetare qe individualizon nje produkt ose sherbim perfshin ne kuadrin mbrojtjes ligjor subjektin qe gezon te drejten e perdorimit te kesaj marke ( pronari i markes ) duke i garantuar mjete mbrojtese ndaj cdo veprimi cenes ne perdorimin e markes te tij, te njejte apo te ngjashme, per te njejtin lloj produkti ose sherbimi apo nje produkt ose sherbim te ndryshem, duke mbrojtur jo vetem interesat pasurore dhe jopasurore te tij, por dhe ato te konsumatoreve.

Analiza e pretendimeve per perdorimin e paautorizuar te markes “Zgara korcare “ nga pala e paditur gjate ushtrimit te aktivitetit te saj tregetar orienton arsyetimin, referuar dispozitave te sipercituara te ligjit “Per pronesine industriale” dhe konventave nderkombare ( Konventa e Parisit 1883), ne elementet dhe kriteret e meposhtme krahasuese :

a)Krahasimi i shenjave vizualisht dhe fonetikusht te ngjashme: referuar ketij kriteri gjykata duhet te tregoje kujdes ne analizen e ngjashmerise vizuale, fonetike dhe konceptuale mes markes se rregjistruar dhe asaj qe pretendohet se perdoret nga pala e paditur. Ky krahasim duhet te bazohet ne pershtypjen e pergjithshme qe markat percjellin, duke marre ne konsiderate komponentet dallues dhe dominant te tyre. Gjetja e ngjashmerive qofte dhe ne njerin prej elementeve objekt krahasimi perben baze te mjaftueshme per te konsideruar palen e paditur ne kushtet e perdorimit te paautorizuar te markes pronesi e pales

paditese.

Ne gjykim u administruan ne cilesine e proves pamje fotografike nga vendi i ushtrimit te aktivitetit tregetar te pales se paditur ne \*\*\* ku evidentohet ekspozimi i dukshem publik i emertimit “ Zgara korcare origjinale“ me qellim reklamimin dhe individualizimin e sherbimit te ofruar ne fushen e tregimit te produkteve te zgares. Vertetesia e ketij fakti u pranua ne gjykim nga vete pala e paditur \*\*\*, sikurse u konfirmua dhe nga eksperti grafik \*\*\* gjate kqyrjes se objektit.

Per nevoja te krahasimit vizual te markes se perdorur nga pala e paditur ne raport me marken “ Zgara korcare “ te rregjistruar ne pronesi te pales paditese gjate gjykimit u realizua nje ekspertim grafik, nga i cili konkludua :

“ Karakteristikat grafike dhe vizuale te emertimit “Zgara korcare” te paraqitur nga pala paditese jane :

a)Fonti i gemes se zgjedhur eshte i karakterit “Mistral”, kompjuterik b-capital kaligrafi c- me ngjyre te bardhe dhe nuance okre d) ngjyra e sfondit kaf ( germa te bardha me nuance okre mbi sfond kaf )

Karakteristikat grafike dhe vizuale te emertimit “Zgara korcare” te perdorur nga pala e paditur jane :

“a- fonti i gemes i zgjedhur eshte i karakterit “Century”, kompjuterik b-te vogla shtypi ( germa e pare kapitale) c-me ngjyre te verdhe d- ngjyra e sfondit druri kaf ( germa e verdhe mbi sfondin kaf )

Elementet grafike dhe vizuale te perbashket : emertimi dhe ngjyra kafe e sfondit.

Te vecante, karakteri i fontit dhe ngjyra e germave.

Konkluzioni : duke krahasuar emertimin e dy subjekteve ne gjykim, percaktoj se ndryshimi i fontit te emertimit “Zgara korcare” nga “Mistral “ne “Century”, ngjyra e germave nga e bardha ne te verdhe si dhe ngjyra kafe e sfondit ) e perbashket )nuk bejne ndonje ndryshim. Emertimi i njejte dhe diferencat e vogla grafike nuk permbushin kushtet per ta cilesuar kete emertim identifikues, te ndryshem nga ai i markes tregetare te rregjistruar. Percaktoj se emertimi i perdorur nga pala e paditur per te identifikuar aktivitetin e saj tregetar eshte i njejte me marken tregetare te rregjistruar nga pala paditese”

Sa me siper gjykata konkludon se ne aspektin vizual emertimi i perdorur nga pala e paditur per identifikimin e sherbimit te ofruar ka ngjashmeri te theksuara ne raport me marken tregetare “ Zgara korcare” te rregjistruar ne pronesi te pales paditese. Ne te dy rastet komponenti identifikues eshte elementi verbal “ Zgara korcare”, i stilizuar, i cili eshte dominues ne sfondin e perdorur. Ky element eshte inkorporuar teresisht ne emertimin e perdorur nga pala e paditur. Ndryshimi ne llojin e shkrimit dhe nuancat e peraferta ne ngjyra te perdorura nga pala e paditur, sikurse dhe prapashtesa “origjinale “, nuk zbehin ngjashmerine e theksuar me marken e rregjistruar nga pala paditese “ Zgara korcare”.

Ndersa ne aspektin fonetik emertimi “ Zgara korcare” i perdorur

nga pala e paditur eshte identik me marken e rregjistruar nga pala paditese, duke krijuar konfuzion ne dallimin e sherbimeve te ofruara nga secili subjekt.

2.Ngashmeria referuar konfuzionit qe krijohet ne treg ne raport me sherbimet e ofruara.

Mundesia per konfuzion ne treg e konsumatorit mes markes se rregjistruar konform ligjit dhe asaj qe perben imitim perfshin elementet bashkelidhes qe krijojne ngjashmeri jo vetem ne raport me shenjat ne aspektin vizual,por dhe me mallrat dhe sherbimet qe ato identifikojne. Ne kete rast merret ne konsiderate shkalla e vemendjes se nje konsumatori mesatar i cili identifikimin e sherbimit apo produktit, ne varesi dhe te natyres se tij, ia beson memorjes vizuale te markes dhe jo perqendrimin ne elementet e vecante dallues te saj apo nje marke imituese. Ne kete rast elementi krahasues ngrihet ne rrafshin konceptual, pra atashimi qe i behet mallit ose sherbimit nga subjekti qe perdor ne menyre te paautorizuar marken tregetare, i cili ka karakter identik ose te ngjashem me produktet ose sherbimet e mbrojtura nga marka e rregjistruar duke krijuar konfuzion ne treg te konsumatorete. Ne kete rast preket ne menyre te drejteperdrejte tregu i krijuar nga pronari i markes se rregjistruar ne lidhje me tregetimin e mallit ose sherbimit qe mbrohet nga kjo marke duke sjelle si pasoje deme me natyre pasurore ose jopasurore.

Ne rastin objekt gjykimi sherbimet e identifikuara nga pala e paditur permes emertimit “ Zgara korcare origjinale” ( sherbime restoranti te produkteve te zgares te identifikuara ne elementit gjeografik te zones se origjines ) jane identike me sherbimet qe mbulon marka e rregjistruar nga pala paditese “ Zgara korcare”. Duke i bashkalidhur ketij elementi ngjashmerite vizuale dhe perputhshmerine fonetike mes markes se paditesit dhe asaj te perdorur nga pala e paditur evidentohet qartazi konfuzioni i pashmangeshem ne treg mes sherbimeve te ofruar nga secili prej ndergjyqesave.

Sa me siper eshte evidente se pala e paditur \*\*\* gjate ushtrimit te aktivitetit te saj tregetare ( sherbim -prodhime zgare) perdor ne menyre te paautorizuar dhe ne kundershtrim me ligjin marken e rregjistruar nga pala paditese “ Zgara korcare”. Ky konstatim eshte konkluzion i analizes se sipercituar te elementeve thelbesor krahasues vizual, fonetik dhe konceptual mes markes se paditesit dhe markes imituese te perdorur nga pala e paditur.Perdorimi i markes “ Zgara korcare “ nga pala e paditur vjen ne kundershtrim me dispozitat e ligjit “Per pronesine industriale “ qe konturon qartesisht sjelljen tregetare te subjekteve ne qarkullimin civil ne respektim te te drejtave te pronesise industriale te njohura me pare, rregjistruar dhe mbrojtur ne formen e kerkuar nga ligji nga nje tjetere subjekt. Kjo situat e kundralishmerie legjitimon palen paditese ne kerkimin e saj per ndalimin e perdorimit te paautorizuar te markes “ Zgara korcare “ nga pala e paditur referuar ligjit “ Per pronesine industriale “.

Perdorimi i paautorizuar nga pala e paditur e markes se rregjistruar nga pala paditese “Zgara korcare” perben dhe cenim te parimeve



ligjore te konkurrences se ndershme, ku perfshihet cdo veprim qe ne kundersiztim me praktikat tregetare sjell konfuzion te konsumatori si rezultat i perdorimit te nje marke, shenje, etikete, paketimi ose cdo tregues tjeter i mallrave qe karakterizon veprimtarine e nje subjekti te caktuar, te mbrojtur rregullisht sipas ligjit.

Ne keto kushte gjykata cmon se kjo pjese e kerkimit te padise duhet pranuar duke urdheruar ndalimin e perdorimit te paautorizuar te markes "Zgara korcare" ne qarkullimin tregetar ne vendin ku ushtron aktivitetin i padituri \*\*\* (\*\*\* ) i cili detyrohet te heqe emertimin " Zgara korcare".

Si pasoje e perdorimit te kundraligjshem te markes nga pala e paditur, paditesi shoqeria " \*\*\*n \*\*\*" sh.p.k kerkon ti shperblehet demi pasuror dhe jopasuror referuar neneve 608, 625, 640 te KC te cilet respektivisht sanksionojne :

"Personi qe ne menyre te paligjshme dhe me faj i shkakton tjetrit dem ne perosnin ne personin ose pasurine e tij detyrohet te shperbleje demin e shkaktuar. Personi qe ka shkaktuar demin nuk pergjigjet kur provon se nuk ka faj. Demi quhet i paligjshem kur eshte rrjedhim i shkeljes ose cenimit te interesave dhe te drejtave te tjetrit qe mbrohen nga rendi juridik ose zakonet e mira" ( neni 608 );

"Personi qe peson nje dem jopasuror ka te drejte te shperblehet kur a) ka pesuar demtim te shendetit, te integritetit fizik dhe psikik te tij b) eshte cenuar nderi, personaliteti dhe reputacioni i tij c) eshte cenuar e drejta e emrit c) eshte cenuar respektimi i jetes private d) eshte cenuar kujtimi i nje te vdekuri. Ne kete rast bashkeshorti I personit te vdekur ose te afermit e tij deri ne shkalle te dyte mund te kerkojne shperblimin e demit jopasuror ( neni 625 )

"Demi pasuror qe shperblehet perbehet nga humbja e pesuar dhe fitimi i mugar..(neni 640)

Nga analiza e dispozitave te mesiperme ligjore rezulton se pergjegjesia civile ne shkaktimin e demit jashtekontraktor lind ne kushtet e vertetimit ne menyre kumulative te kater elementeve 1. veprimit te paligjshem 2. demit pasuror ose jopasuror 3. fajit ne shkaktimin e demit 4. lidhjes shkaktesore mes veprimit te paligjshem dhe demit te shkaktuar

Veprimi i paligjshem ne shkaktimin e demit cilesohet nje kategori objektive, shfaqja e kundraligjshme e vullnetit te subjektit te se drejtes qe sjell si pasoje shkeljen ose cenimin e te drejtave, lirive dhe interesave te te treteve qe mbrohen nga rendi juridik dhe zakonet e mira. Kundraligjshmeria e sjelljes se subjektit shkaktar te demit cenon marredheniet juridike, qe gezojne mbrojtje nga kushtetuta, aktet nderkombetare, ligjet dhe aktet nenligjore, te cilat njohin dhe garantojne te drejtat e personave fizik dhe juridik ne raport me njeri tjetrin dhe pushtetin publik.

Faji eshte qendrimi subjektiv i personit shkaktar te demit ne raport me veprimin e kundraligjshem dhe pasojat qe vijne prej tij, qe nenkupton vullnetin e brendeshem psikik per te kryer veprimin, per te siguruar ardhjen e

pasojave ose lejimin e ardhjes se tyre.

Lidhja shkakesore vleresohet si ekzistenca e lidhjes objektive, te drejteperdrejte dhe te pavarur nga vullneti i subjektit shkaktar te demit mes veprimit te kundraligjshem dhe pasojes se ardhur. Lidhja shkakesore verteton lidhjen mes tre elementeve objektive dhe subjektive te faktit te paligjshem; konkretisht sjelljes se paligjshme, fajit dhe pasojes se ardhur, pra demit te shkaktuar ne pasurine, shendetin ose personalitetin e subjektit te demtuar. Elementi i lidhjes shkakesore mbeshetet ne parimin *condicio sine qua non* sipas te cilit nuk do te vertetohej ardhja e pasojes se demshme nese nuk do te kishte ndodhur shkak, sjellja e paligjshme dhe faji per shkaktimin e demit.

Demi i cili mund te kete karakter pasuror ose jopasuror.

Demi jopasuror ne rastin e subjekteve tregtare prek sferen e reputacionit dhe emrit te mire tregtare te krijuar prej tyre gjate ushtrimit te veprimtarise ekonomike, duke sjelle pasoja ne lidhje me marredheniet me te tretet, vecanerisht me klientelen apo me sjelljen e ardhshme ne treg dhe pritshmerite per krijimin e raporteve te reja tregtare.

Nga provat e nenshtuara hetimit gjyqesor arrihet ne konkluzionin se pala e paditur permes perdorimit te kundraligjshem te markes “ Zgara korcare “ gjate ushtrimit te aktivitetit te saj tregetar ka sjelle si pasoje cenimin e emrit dhe reputacionit te pales paditese. Ofrimi ne treg nga pala e paditur e sherbimit restorant “produkte zgare “ duke i atashuar marken e paditesit ka indentifikuar sherbimin ne fjale me ato qe mbulohen nga marka e rregjistruar tregtare “ Zgara korcare” e cila pa dyshim individualizon karakteristika dhe cilesi te ndryshme dalluese nga ato te pales se paditur. Duke marre ne konsiderate ngjashmerite mes markes pronesi e pales paditese dhe asaj te perdorur ne qarkullimin tregetar nga e paditur, sikurse dhe natyren e njejte te sherbimit te ofruar prej tyre eshte bindeshem e paevitueshme konfuzioni qe krijohet ne treg te konsumatori dhe pamundesia per dallimin mes tyre. Duke ofruar ne treg nje sherbim krejtesisht te ndryshem ne cilesi nga ai qe mbulon marka e rregjistruar “ Zgara korcare “, permes perdorimit te paautorizuar te kesaj te fundit, pala e paditur ka cenuar emrin e mire te krijuar ne treg nga pala paditese permes markes se rregjistruar prej tij.

Paditesi rezulton te kete rregjistruar prej disa vitesh marken “ Zgara korcare” duke qene i pranishem ne treg me sherbimet e mbuluara nga kjo marke, eshte i mirenjohur per konsumatoret e kesaj kategorie sherbimi dhe ka krijuar nje pozite te konsoliduar ne qarkullimin tregetar. Publiciteti i markes se paditesit permes ekspozitimit ne treg dhe reklamimi prej tij i sherbimeve te mbuluara prej saj duke siguruar njohjen e tij ne treg ne radhet e konsumatoreve padyshim qe eshte cenuar nga perdorimi i padrejte i markes se tij nga e paditur \*\*\*.Per kete shkak kjo pale duhet te detyrohet gjyqesisht ti shperbleje paditesit demin jopasuror te shkaktuar ne baze te neneve 608 te KC dhe nenit 184/c te ligjit “Per pronesine industriale”.

Persa i takon mases se demit gjykata mori ne konsiderate kohezjaten e

perdorimit te pautorizuar te markes nga pala e paditur, e cila daton 04.03.2014, emrin e mire dhe reputacionin qe gezon ne treg marka e rregjistruar nga pala paditese, keqbesimin e pales se paditur ne perdorimin e markes se pales paditese, ne kushtet e venies ne dijeni prej saj ne lidhje me te drejtat e fituara mbi marken “Zgara korcare” dhe vijimesine e ketij cenimi. Sa me siper duke patur per qellim rivendosjen e te drejtes se shkelur, ne menyre proporcionale me demin e pesuar dhe bazuar ne teresine e rrethanave te ceshtjes gjykata cmon se pala e paditur duhet te demnshperbleje paditesin per demin jopasuror te pesuar ne masen \*\*\* leke.

Ne perfundim gjykata vendos pranimin pjeserisht te kerkesepadise duke pranuar nga masa e pretenduar e demit jopasuror vleren \*\*\* leke duke rrezuar kerkimin per diferencen e saj.

### **PER KETO ARSYE**

Ne baze te neneve 306 dhe 309 te KPrC , gjykata

### **V E N D O S I**

- 1.Pranimin pjeserisht te kerkesepadise.
  2. Ndalimin e perdorimit te paautorizuar te markes tregetare “Zgara Korcare” ne qarkullimin tregetar ne vendin ku ushtron aktivitetin personi fizik tregetar \*\*\* \*\*\* duke urdheruar te paditurin te heqe nga ambientet ku ushtron aktivitetin emertimin e markes “Zgara Korcare”.
  - 3.Detyrimin e pales se paditur \*\*\* , person fizik qe ushtron aktivitet tregetar, ti demshperbleje paditesit shoqeria \*\*\* sh.p.k demin jopasuror te shkaktuar nga perdorimi i paautorizuar i markes “Zgara Korcare “ne shumen \*\*\* leke.
  - 4.Rrezimin e padise per pjesen tjeter te saj.
  - 5.Leshimin e urdherit te ekzekutimit per kete vendim gjyqesor.
  - 6.Shpenzimet gjyqesore i ngakohen paleve ndergjyqese ne raport me pjesen e pranuar dhe te rrezuar te padise.
  7. Kunder ketij vendimi lejohet ankimi ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 diteve nga e nesermja e shpalljes se vendimit. Per palet ne mungese ky afat fillon nga e nesermja e njoftimit te vendimit.
- U shpall sot ne Tirane me dt 24.10.2016.**

**SEKRETARE  
GJYQTARE**

**DILA  
ANTONELA PRENDI**

**DOÇI**

**SHPENZIMET GJYQESORE**

Takse gjyqesore \*\*\* leke

Shpenzime fletethirrje \*\*\* eke

Shpezime avokati te pales paditese \*\*\* leke

Shpenzime ekspertimi \*\*\* leke